



FËMIJËT E PREKUR NGA FEMICIDI

Në total, **37 fëmijë u prekën nga këto femicide**. Nga viktimat e këtyre femicideve, 20 gra kishin fëmijë, 9 prej tyre kishin fëmijë nën 18 vjeç, ndërsa 11 kishin fëmijë mbi 18 vjeç.



FEMICIDET SIPAS VENDIT TË NGJARJES

Rreth **60% e femicideve** u kryen në banesën ku jetonte viktimja.



4. VENDIMET GJYQËSORE PËR FEMICIDET


ÇËSHTJET GJYQËSORE SIPAS STATUSIT

Nga **24 çështjet e femicideve**, **16 kanë përfunduar**. Nga këto, **9 autorë janë dënuar**, **6 çështje janë pushuar** (pasi autori ka humbur jetën pas ngjarjes), dhe për 1 rast është dhënë vendim për mjekim të detyruar. Ndërkohë, **6 çështje janë ende në proces gjyqësor**.



TË DËNUAR SIPAS MASËS SË DËNIMIT

Nga autorët e dënuar, 5 janë dënuar me burg nga 12 deri në 30 vjet, ndërsa 4 janë dënuar me burgim të përjetshëm.



VRASJA E GRAVE DHE VAJZAVE DHE FEMICIDI NË SHQIPËRI 2021-2023

Gjetje të Observatorit për Femicidin, i krijuar pranë zyrës së Avokatit të Popullit

1. VRASJET E GRAVE DHE VAJZAVE


Në periudhën 2021-2023, në Shqipëri janë regjistruar **32 raste të vrasjes së grave dhe vajzave**, nga të cilat **24 raste femicidi** (vrasje me dashje për shkak të gjinisë). Vrasjet kanë ndodhur në 19 bashki, ku numri më i madh është regjistruar në Tiranë (6 raste), ndjekur nga Fieri (4 raste) dhe Elbasani (3 raste).

VRASJE TË LIDHURA ME GJININË (FEMICID)

Gra dhe vajza që vriten nga partnerët e tyre

Gra dhe vajza që vriten nga pjesëtarët e familjes

Gratë dhe vajzat e vrara nga autorë të njohur/të panjohur, ku mënyra e kryerjes së vrasjes përmbush të paktën njërin nga kriteret e mëposhtme:




Bazuar në prova të forta që vrasjet nga partnerët intimë ose anëtarët e tjerë të familjes janë të bazuara në faktorë të lidhur me gjininë.



Kriteret për të identifikuar faktorët që lidhen me gjininë.


STATISTIKA SIPAS VITEVE

Viti **2023** shënon numrin më të lartë të vrasjeve të grave dhe vajzave, me **13 raste**.




STATISTIKA SIPAS GRUPMOSHËS

Shumica e grave dhe vajzave të vrara kanë qënë të moshës **30-44 dhe 45-59 vjeç**.




STATISTIKA SIPAS STATUSIT MARTESOR

3 nga 4 gra viktima kanë qenë të martuara.




STATISTIKAT SIPAS NIVELIT ARSIMOR

60% e grave dhe vajzave viktima kanë pasur arsim 8/9-vjeçar.



SIPAS STATUSIT TË RAPORTIMEVE TË MËPARSHME

Më pak se 20% e tyre kishin raportuar më parë dhunën në familje, dhe vetëm 2 prej tyre kishin përfituar urdhër mbrojtjeje (UMM/UM).




VRASJET E GRAVE ME FËMIJË

4 nga 10 gra të vrara ishin me fëmijë nën 18 vjeç.




SIPAS STATUSIT NË PUNËSIM

Më shumë se gjysma e tyre kanë qenë papunë apo në pension në momentin e vrasjes.



LIDHJA E VIKTIVAVE ME AUTORIN


Në 27 raste, viktimat kishin lidhje familjare me autorin; në 18 raste, autori ishte partneri/ish-partneri, ndërsa në 9 raste ishte një familjar tjetër.



2. AUTORËT

Për 32 rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave, janë identifikuar nga autoritetet 28 autorë. Në dy raste autorët mbeten ende të paidentifikuar. Rreth një e treta e autorëve i përkasin grupmoshës 45-59 vjeç, dhe shumica ishin burra, ndërsa vetëm dy gra rezultuan autore. 4 në 10 autorë kishin arsim 8/9-vjeçar, dhe afërsisht gjysma e tyre ishin të papunë në momentin e kryerjes së krimit.

AUTORËT SIPAS KARAKTERISTIKAVE DEMOGRAFIKE




3. FEMICIDI

Femicidi është forma më ekstreme e dhunës me bazë gjnore dhe nënkupton vrasjet e grave dhe vajzave për motive që lidhen me gjininë (UNODOC, UN Women, 2022). Nga 32 rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave në periudhën 2021-2023, 24 janë identifikuar si femicide, duke përfaqësuar një pjesë të konsiderueshme të rasteve të dhunës ekstreme ndaj grave. Nga analiza e materialeve mbi rastet e femicideve rezulton se në 90% të rasteve, viktimat kishin përjetuar dhunë nga autorët para kryerjes së vrasjes.

NORMA E FEMICIDIT SIPAS DISA SHITETEVE

Në 2023, Shqipëria shënoi një normë femicidi prej **0.84 për 100,000 femra, më e lartë se ajo e vitit 2022**. Me këtë normë Shqipëria renditet pas Malit të zi, Greqisë, Serbisë, Kroacisë, Maltës, Bosnje e Hercegovinës, Cekisë dhe Bullgarisë të cilat kanë një normë më të ulët, ndërsa renditet para Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë të cilat kanë një normë më të lartë.

Krahasuar edhe me disa nga vendet e tjera jashtë kontinentit evropian, gjatë vitit 2023 norma e femicidit në Shqipëri ishte më e ulët se në SHBA, Meksikë, Kosta Rika dhe Mongoli dhe më e lartë se në Marok, Algjeri dhe Jordani.



*BIH- BOSNJA DHE HERZEGOVINA